# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-471203**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “U emërua në atë post jashtë çdo kriteri”, Berisha për skandalin e SHISH-it: Vlora Hyseni është kthyer për t’u dhënë reston bashkëpunëtorëve që e tradhtuan |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/u-emerua-ne-ate-post-jashte-cdo-kriteri-berisha-per-skandalin-e-shish-i-i106164` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 11:00:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 10:29:56 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bd9e5d2591af1bda0e7a47395831fba3eb8f0a63254e89661b94979693016bc5` |
| TEKSTI | `7f460d830bade6a4e1390265c2e1b8e00f4b9025442211b871a343effe9df3a7` |
| PAMJA | `9362d17e6ec1a6e432f662c3fa06e06d72beb43f662c14aad0111e17a503095d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e83ad8d6fe573fd48cc876837d66fdb56ad42e7ac687dc61ee1161c5c0f23e0c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e83ad8d6fe573fd48cc876837d66fdb56ad42e7ac687dc61ee1161c5c0f23e0c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# "U emërua në atë post jashtë çdo kriteri", Berisha për skandalin e SHISH-it: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë reston bashkëpunëtorëve që e tradhtuan

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 12:29



Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, gjatë një bashkëbisedimi me qytetarët në rrjetet sociale, e ka cilësuar javën që lamë pas si periudhën e një skandali të jashtëzakonshëm në historinë e Shqipërisë, me përmasa që sipas tij njohin vetëm dy raste të ngjashme në të gjithë historinë botërore. Berisha u ndal gjatë te çështja e ish-drejtueses së Shërbimit Informativ Kombëtar, Vlora Hyseni, dhe lidhjet e saj me krimin e organizuar.

Lideri i PD deklaroi se caktimi i masës së sigurimit ndaj drejtueses së shërbimit inteligjent përbën goditjen më të rëndë për shtetin, pasi kreu i SHISH-it është zyrtari që presupozohet të jetë i certifikuar për shkallën më të lartë të besueshmërisë.

Kreu i PD-së rikujtoi se emërimi i Vlora Hysenit në atë detyrë ishte bërë absolutisht jashtë çdo kriteri, duke theksuar se ai vetë e ka denoncuar këtë fakt që në javën e parë të marrjes së detyrës prej saj. Gjithashtu, Berisha përsëriti akuzat ndaj Ergys Agasit, duke deklaruar se ai kishte vendosur kontroll të plotë mbi shërbimin informativ.

**Berisha:** Java që lamë pas është java e skandalit më të jashtëzakonshëm jo vetëm në historinë e Shqipërisë, por e një skandali që njeh gjithsej edhe dy raste të tjera të ngjashme në historinë e botës. Shefja e shërbimit inteligjent të vendit arrestohet për bashkëpunim me organizatën kriminale më të rrezikshme në Evropë të Ergys Agasit për nxjerrje të sekretit shtetëror duke shkaktuar kështu rënien e plotë të piramidës së sigurisë së vendit.
Për qytetarët shqiptarë shtoj se arrestimi për bashkëpunim me krimin dhe për nxjerrjen e sekretit i shefit të shërbimeve është më i rëndë se arrestimi i çdo zyrtari tjetër të vendit për këto dy vepra penale sepse ai presupozohet se është i certifikuar për shkallën më të lartë të besimit.
Ndërkohë që Vlora Hyseni është emëruar në atë post absolutisht jashtë çdo kriteri dhe përbën kjo një nga çështjet më madhore që kërkon përgjigje.
Vlora Hyseni është denoncuar nga Sali Berisha, por mundet edhe të tjerë, që në javën e parë të emërimit të saj të pamerituar në atë detyrë dhe në vazhdim.
Ergys Agasi është akuzuar nga Sali Berisha në mënyrë të përsëritur se kishte në kontroll të plotë shërbimin informativ kombëtar.
Vlora Hyseni arrestohet apo shpallet urdhër arresti në një kohë kur ajo nuk ishte në qeveri, çka dëshmon se qeveritarët aktualë donin me çdo kusht që ajo të kthehet.
Por ajo u kthye dhe me sa duket është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan, sipas saj.
Ndaj dhe zhvillimet e mëpastajme do jenë po të këtij kalibri, po të këtij niveli.

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 25 Shtator22:40

**[Sulmi me vezë ndaj Ramës në Nju Jork jehonë edhe në mediat e mëdha greke]**

Tensionet u ndezën gjatë mbërritjes së Edi Ramës në Asamblenë e 81-të të Përgjithshme të OKB-së, nd&...

POLITIKE 25 Shtator22:38

**[“Prania besnike e Edi Ramës dhe Erion Braçes”/ Aktivistja përplaset me deputetin: Qeverisë tuaj duhet t’i vijë turp që ka guxim të dalë përballë qytetarëve]**

Një përplasje verbale është shënuar ditën e sotme mes akivistes Arvina Lleshi dhe deputetit socialist Erion Braçe...

POLITIKE 25 Shtator22:10

**[“Rama do ngelet vetëm e do përfundojë keq”/ Aktivisti Lika: SPAK do godasë Ballukun dhe Ballën, ky pushtet do shembet]**

Aktivisti Edison Lika, foli për protestat qytetare kundër qeverisë dhe aktualitetin politik. Lika u shpreh se Rama do ngelet vetëm në ...

POLITIKE 25 Shtator21:22

**[Si e komenton Brukseli, skandalin me Vlora Hysenin?]**

Komisioni Europian është pyetur për skandalin që ka përfshirë SHISH dhe masën “arrest shtëpie” ndaj Vlora Hy...

POLITIKE 25 Shtator20:58

**[“Balluku me akuza, Vlora Hyseni nën arrest”, Ish-kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë: Dosja të tëra në hetim për lidhjet e krimit me pushtetin. Ç’duhet të ndodhë tjetër?]**

Zhvillimet e fundit në vend kanë sjellë një reagim nga ish-kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço, i cili ndal...

POLITIKE 25 Shtator20:23

**[Protesta e 118-të/ Arben Kola: Kryeministri qëndron në dhomë 15 mijë dollarë nata, ndërsa spitalet janë pa ilaçe]**

Aktivisti Arben Kola: Dua të nis me një falënderim për shqiptarët e Amerikës dhe një prej koordinatorëve që që...

POLITIKE 25 Shtator20:18

**[Protestuesit dhe studentët sfidojnë shiun! Mbyllen fjalimet te Kryeministria, nis marshimi në rrugët e Tiranës]**

Protestuesit dhe studentët kanë sfiduar reshjet e shiut mbrëmjen e sotme, duke vijuar tubimin kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Ram...

POLITIKE 25 Shtator20:13

**[Aktivisti thirrje Eric Wendt: Na jepni një dorë, duam të krijojmë një qeveri të fortë]**

Nga protesta e 118-të kundër qeverisë, aktivisti Erald Ndoj ka zgjedhur t’i drejtohet publikisht ambasadorit të ri të Shteteve t&...

POLITIKE 25 Shtator20:04

**[“Këtu mbaron predikimi im në shkretëtirë…!”/ Rama mbajti fjalimin në OKB, salla thuajse bosh]**

Kryeministri Edi Rama ka përfunduar fjalën e tij në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ku ishte e gjitha e fokusuar në Inteligjen...

POLITIKE 25 Shtator19:58

**[Protestat në Tiranë/ Rama: Algoritmi aktivizoi urrejtjen! Qytetarët protestuan kundër një armiku fantazmë]**

Kryeministri Edi Rama foli për protestat në Tiranë, të cilat po vijojnë prej më shumë se tre muajsh, përmes së...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

**[“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...]**

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

SHOWBIZ 25 Shtator

**["Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...]**

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u p&eum...

AKTUALITET 25 Shtator

**''Bleona është gjallë!''/ Gjyshi rrëfen misteri...**

Prej 16 vitesh, fati i Bleona Matës mbetet i pazbardhur. Vajza vetëm 6 vjeçe humbi gjurmët më 22 maj 2010 në Zapod të Kuk...

INVESTIGIME 26 Shtator10:33

**Nga tritoli te kërcënimet me jetë/ Çfarë po ndodh me policin Altin Preka?**

Altin Preka, efektiv i Policisë së Shkodrës, rrëfen për "Piranjat" historinë e përplasjeve të tij me epror...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**





**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.